



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË

Nr 5414/prot.

Tiranë, më 24.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1622, datë 03.04.2013.

SHOQËRISË "EMMA CHROME" SH.P.K
Rruga "Musa Agolli, Nr.19, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Emma Chrome" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1622, datë 03.04.2013, për mineral kromi, në objektin "Vlahna", Golaj, Bashkia Krumë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5834, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5414, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1622, datë 03.04.2013, për mineral kromi, në objektin "Vlahna", Golaj, Bashkia Krumë, Qarku Kukës, për arsye se nuk është kryer pagesa e rehabilitimit vjetor për vitin 2016-2017, 2017-2018 në vlerën 2 274 972 lekë përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Gjithashtu, kenë ndërprerë veprimtarinë minerare për më shumë se tre vite, pa njoftuar më parë, siç përcaktohet në gërmat "d" dhe "dh", të nenit 18, të ligjit të sipërcituar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "c" dhe "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1622, datë

03.04.2013, për mineral kromi, në objektin "Vlahna", Golaj, Bashkia Krumë, Qarku Kukës, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1622, datë 03.04.2013, për mineral kromi, në objektin "Vlahna", Golaj, Bashkia Krumë, Qarku Kukës.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

